



Агенција за вработување на
Република Македонија

Me qëllim që të mundësojë pjesëmarrje dhe përfshirje sa më të madhe të personave të papunë, të cilët janë të interesuar që punësimin e tyre ta zgjidhin përmes Programit të vetëpunësimit, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimit për vitin 2012 dhe Programit të Punës së Qeverisë të Republikës së Maqedonisë 2011-2015, më datën **01.02.2012**, sërish bën

SHPLLJE PUBLIKE

për

personat e papunë

1. U bëhet thirrje të gjithë personave që janë të evidentuar si të papunë të cilët janë:

- Persona të evidentuar si të papunë më tepër se gjashtë muaj;
- Persona që më herët kanë qenë të punësuar në vëprimtarinë e energjetikës, por të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës për arsye afariste;
- Ushtarët profesionistë të cilëve u është ndërprerë shërbimi në ARM;
- Persona të rinj deri në moshën 27 vjet;
- Shfrytëzues të kompenzimit me pagesë në bazë të papunësisë.

si dhe:

shfytëzyuesit e ndihmës sociale me pagesë, personat me statusin e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, viktimat e dhunës familjare, personat pa shtëpi, konsumuesit e mëhershëm të drogës, prindërit e fëmijëve në rrugë, prindërit vetëmbajtës, prindërit me katër ose më tepër fëmijë të mitur, gratë e moshës prej 29 – 49 vjet, personat nën mbrojtjen suspendiale, mbledhësit e mbeturinave PET, romët, çiftet e reja bashkëshortore me ose pa fëmijë deri në moshën 45 vjet, personat e moshës prej 55 deri 62 vjet, personat e dënuar pas lirimit nga institucioni ndëshkëimor përmirësues, shfrytëzuesit e kompensimit me pagesë në bazë të papunësisë, personat e evidentuar si të papunë një kohë të gjatë (më tepër se një vit në APRM), personat e evidentuar si të papunë më tepër se gjatë muaj,

dhe të cilët punësimin e tyre duan ta zgjidhin me mbështetjen financiare përmes **Programit të vetëpunësimit**, që të paraqiten në klubet e punës së qendrave të punësimit të APRM-së ku rregullisht evidentohen si persona të papunë.

2. Mbështetja financiare përfshin pagesën e mjeteve të pakthyeshme për furnizimin me pajisje dhe/ose me repromateriale në një shumë prej 185.000 denarësh dhe ndihmën për harxhimet e regjistrimit të firmës.
3. Personat sipas pikës 1 të kësaj shpalljeje publike të cilët janë themelues të firmës dhe të cilët do të mbështetet financiarisht, më së paku katër vjet nuk mund të evidentohen si persona të papunë në APRM. Në qoftë se e ndërprejnë ushtrimin e veprimitarisë (dhe me këtë e ndërprejnë edhe marrëdhënien e punës) para se të kalojë një vit nga data e regjistrimit të biznesit, ose vetëm u ndërpritet marrëdhënia e punës, ndërsa në vend të tij nuk punësohet menjëherë një person tjetër, ka obligim që t'i kthejë 80 për qind të mjeteve financiare të shfrytëzuara për pajisje dhe/ose repromateriale në formë të parave, në një periudhë prej 12 muajsh.
4. Personat e papunë të cilët janë të interesuar sipas pikës 1 të kësaj shpalljeje publike, fletëparaqitjet e tyre mund t'i dorëzojnë më së voni deri më **07.02.2012** në klubet e punës së 30 qendrave të punësimit të RM-së.
5. Kushtet, të drejtat dhe obligimet më konkrete do të rregullohen me nënshkrimin e marrëveshjes së personave të papunë me APRM-në dhe UNDP-në.

Informata të hollësishme mund të merren në klubet e punës së 30 qendrave të punësimit të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, në qendrën e kontaktimit 02/3298-297 dhe ueb faqen www.avrm.gov.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË